



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 157, Datë 31.07.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “H.K. HEC GRABOVA 2” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 996/8 prot., datë 30.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “H.K HEC GRABOVA 2” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996 prot., datë 25.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet prodhues 10.8 MW, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, Qarku Elbasan.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 09.05.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.05.2024 dhe 13.05.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.06.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE me shkresën nr. 1641 prot., datë 15.07.2024 ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 996/3 prot., datë 20.05.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria me shkresën me nr. 996/4 prot., datë 03.06.2024, ka përcjellë dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Në vijim, për shkak të saktësimeve/sqarimeve në lidhje me afatet e ndërtimit dhe vënies në punë të hidrocentralit në referencë të përcaktimeve të kontratës së Koncesionit nr. 2026 rep., nr. 926/1 kol., datë 14.09.2017, për ndërtimin e hidrocentralit “GRABOVA 2”, e ndryshuar, bordi ERE-s me vendimin nr. 134, datë 09.07.2024, vendosi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit me 30 (tridhjetë) ditë mbi aplikimin e shoqërisë “H.K HEC Grabova” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “GRABOVA 2”.
- ERE me shkresën me nr. 996/6 prot., datë 19.07.2024, njoftoi shoqërinë mbi vendimmarrjen e bordit të ERE-s mbi zgjatjen e afatit dhe i kërkoj që të saktësojë/sqarojë në lidhje me afatet e punimeve dhe fillimin e operimit të hidrocentralit.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996/7 prot., datë 23.07.2024 ka depozituar sqarimet/ saktësimet e kërkuara, dhe me shkresën e fundit me nr. 996/7 prot., datë 23.07.2024 ka përcjellë në ERE dokumentacionin drejtuar MIE për zgjatjen e afatit të vënies në punë të hidrocentralit “Grabova 2”.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesë më të lartë se ajo që kërkohet për një njësi gjeneruese, në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores, ndaj në vijim do të bëhen sistemimet përkatëse.
- Përsa i përket mbështetjes financiare për realizimin e projektit, shoqëria ka përcjellë kontratën e nënshkruar të kredisë me Raiffeisen Bank sh.a. me nr. 6412 rep., nr. 3953 kol., datë 22.10.2022 ku shprehet dakordësia për këtë projekt, me afat vlefshmërie deri në 30 Korrik 2024. Në mbledhjen e bordit të datës 31.07.2024 përfaqësuesi i shoqërisë “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k. sqaroi se kanë bërë rishikim/shtyrje të këtij afati në kushtet e kontratës aktuale dhe se brenda muajit Gusht 2024 do disponojnë kontratën e re. Për këtë arsye vlerësojmë t’i lihet kusht shoqërisë të përcjellë brenda muajit Tetor 2024, kontratën e rishikuar të nënshkruar me bankën.
- Kontrata e koncesionit e formës BOT (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “GRABOVA 2” me nr. 2026 rep., nr. 926/1 kol., datë 14.09.2017, nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe subjektit “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k., në nenin 4 të saj përcakton se kjo kontratë lidhet për një afat prej 35 (tridhjetë e pesë) vjetësh, nga data e hyrjes në fuqi të saj dhe mbaron në vitin e 35-të.
- Kontratat shtesë nuk kanë rivënë në afat kontratën bazë në lidhje me vlefshmërinë e saj, si e tillë ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e

ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit sipërcituar, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 6 vjet e 11 muaj nga periudha koncensionare dhe periudha e mbetur është 28 vjet e 1 muaj. Vlefshmëria e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë do të nisë nga data 24.10.2024, datë në të cilën shoqëria do të fillojë operimin sipas afateve të kontratës me MIE-n dhe do të jetë e vlefshme deri në përfundim të afatit të kontratës pra deri më 14.09.2052.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “H.K. HEC GRABOVA 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet total të instaluar 10.8 MW, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, Qarku Elbasan, duke filluar ky afat nga data 24.10.2024 deri në 14.09.2052.
2. Shoqëria “H.K. HEC GRABOVA 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për kërkesën e bërë nga ana e saj mbi zgjatjen e afatit të datës së fillimit të operimit të hidrocentralit “Grabova 2”.
3. Shoqëria “H.K. HEC GRABOVA 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e kredisë të nënshkruar me Raiffeisen Bank sh.a. të rishikuar, brenda muajit Tetor 2024.
4. Ky vendim është objekti rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të tij.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI